



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

**VENDIM**

Nr. 41, datë 21.05.2024

**PËR MIRATIMIN E VLERËS MESATARE TË QIRASË SË APARTAMENTEVE TË BANIMIT PËR EFEKT TË SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR KATEGORITË, QË GËZOJNË PËRPARËSI NË SUBVENCIONIMIN E QIRASË NË TREGUN E LIRË**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.22/2018, “Për strehimin sociale”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në treg të lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 301, datë 15.4.2020 “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 3.7.2019 “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.459, datë 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit në tregun e lirë, për efekt të subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, si më poshtë vijon:

- a) Vlera e qirasë për apartamente me strukturë 1+1, është 30'000 (tridhjetëmijë) lekë/muaj.
- b) Vlera e qirasë për apartamente me strukturë 2+1, është 35'000 (tridhjetepesëmijë) lekë/muaj
- c) Vlera e qirasë për apartamente me strukturë 3+1, është 40'000 (dyzetëmijë) lekë/muaj.

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike për zbatimin e këtij vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 22.05.2024**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 328 / prot.  
6

Durrës, më 29.05 .2024

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

BASHKIA DURRE  
29.05.24 Nr. 5972/3

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.41 datë 21.05.2024 “Për miratimin e vlerës mesatare të qirasë së apartamenteve të banimit për efekt të subvencionimit të qerasë për kategoritë, që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qerasë në tregun e lirë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

